


# CSK-310


## Udhëzuesi i nisjes së shpejtë

### Paneli i përparmë i gjeneratorit CS-3000



1. Butoni "RF ON/OFF"
2. Butonat e rritjes/uljes së fuqisë, Fuqia e vendosur dhe aktuale
3. Butonat e rritjes/uljes së kohës, Koha e caktuar dhe e kaluar
4. Butoni "Mode"
5. Ekran grafik i gjeneratorit
6. Drita treguese LED e modalitetit "Standby"
7. Drita treguese LED e "Error"
8. Drita treguese LED e butonit "RF ON/OFF"
9. Konektori i kabllot\*
10. Konektori i elektrodës shpërndarëse neutrale (elektrodë kthimi ose pllakë tokëzimi)
11. Konektori i pedalit të kontrollit
12. Rezistenca


### Paneli i pasmë i gjeneratorit CS-3000



13. Çelësi i energjisë
14. Konektori i energjisë AC
15. Morsetë tokëzimi (konektor ekuipotencial)
16. Konektori/porta e të dhënave
17. Kontrolli i volumit me alarm

\*Kabllot e lidhura përfshijnë CSK-2000, CSK-2060 ose CSK-2030

# Lidhjet e gjeneratorit CS-3000



## AKTIVIZIMI I GJENERATORIT CS-3000



PARALAJMËRIM



LIDHINI KOMPONENTËT DHE PAJISJET TE NJËSIA ELEKTROKIRURGJIKALE VETËM KUR ENERGJIA RF TË JETË JOAKTIVE. NË TË KUNDËRT, MUND TË SHKAKTOHET LËNDIM OSE GODITJE ELEKTRIKE E PACIENTIT OSE PERSONELIT NË SALLËN E OPERIMIT.

### MBANI DOREZA KUR PËRDORNI GJENERATORIN CS-3000

- Lidhni kabllon e ofruar elektrike në anën e pasme të gjeneratorit CS-3000.
  - Sigurohuni që kabloja elektrike është puthitur plotësisht në fole.
- Futni CSK-310 në një prizë të tokëzuar.
  - Mos përdorni priza të shumëfishta, kablo zgjatuese apo përshtatës spinë treshe-prizë dyshe. Kontrolloni në mënyrë periodike grupin e kabllor elektrike për dëmtim të izolimit apo konektorëve.
  - Sigurohuni që ruhet aksesi në prizën e kabllor elektrike, në mënyrë që kabloja elektrike të mund të hiqet lehtësisht në rast emergjence.
- Në rastin e përdorimit të pedalit të kontrollit, sigurohuni që ai të jetë i lidhur.
  - Dorezat EPI-Sense: Për të nisur energjinë RF (për kryerjen e ablacioneve), shtypni dhe lëshoni pedalin e kontrollit. Për të ndaluar energjinë RF, shtypni dhe lëshoni pedalin e kontrollit.
- Ndizeni duke përdorur çelësin e NDEZJES/FIKJES që gjendet në panelin e pasmë.
  - Pasi ndizet, gjeneratori CS-3000 kryen vetëtestime të sistemit. Vetëtestimet gjenerojnë një sinjal zanor të gjatë që pasohet nga një sinjal zanor i shkurtër në ndezje.



- Verifikoni që të gjenerohen sinjalet zanore.
  - Nëse të gjitha vetëtestimet kalojnë me sukses, gjeneratori CS-3000 kalon në modalitetin "STANDBY".
  - Në rast dështimi të ndonjë prej vetëtestimeve, gjeneratori CS-3000 nxjerr një tingull zanor të vazhdueshëm dhe kalon në modalitetin "FAULT".
- Lidhni dorezën dhe çdo komponent/aksesor të nevojshëm.

### MODALITETET "FAULT"

- Nëse gjeneratori CS-3000 nuk kalon një vetëtestim pas ndezjes apo nëse në çfarëdo momenti zbulohet një gjendje gabimi të parikuperueshëm, gjeneratori CS-3000 hyn në modalitetin "FAULT". Përshkrimi i DEFEKTIT do të shfaqet në ekran.
- Gjeneratori CS-3000 nuk mund të përdoret në modalitetin "FAULT". Energjia RF është e çaktivizuar gjatë modalitetit "FAULT".
- Mesazhet "FAULT" do të qëndrojnë në ekranin grafik të gjeneratorit derisa "FAULT" të fshihet.
- Për të dalë nga modaliteti "FAULT", fikni dhe rindizni gjeneratorin CS-3000. Cikli i fikje-ndezjes do të fshijë gjendjen "FAULT" dhe do të rivendosë kapacitetin për daljen e energjisë RF.
- Paralajmërimet do të qëndrojnë në ekranin grafik të gjeneratorit derisa energjia RF të nisët me anë të pedalit të kontrollit ose butonit "RF ON/OFF" nga korniza e sipërme e përparme.

## KODET E GABIMEVE PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE

### Paralajmërimet (Mesazhet e gabimeve të rikuperueshme)

NUMRI	SHKAKU	ZGJIDHJA
1	<ul style="list-style-type: none"><li>Në ekran: Invalid Device</li><li>Kuptimi: Kodi i identifikimit të pajisjes është jashtë diapazonit të pranueshëm</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Rilidhni ose ndërroni dorezën</li><li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li></ul>
2	<ul style="list-style-type: none"><li>Në ekran: Impedance Limit</li><li>Kuptimi: Rezistenca e matur ose bazë është jashtë diapazonit të specifikuar</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Kontrolloni elektrodën e kthimit, konektorin e saj, dhe nëse është e nevojshme, ripozicionojeni elektrodën</li></ul>
3	<ul style="list-style-type: none"><li>Në ekran: Time Limit</li><li>Kuptimi: Gjeneratori kreu ablacionin siç pritej për kohën e caktuar</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Filloni ablacionin tjetër duke shtypur dhe lëshuar pedalin e kontrollit ose butonin "RF ON/OFF"</li></ul>
4	<ul style="list-style-type: none"><li>Në ekran: User Request</li><li>Kuptimi: Përdoruesi ndërpreu ablacionin</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Filloni ablacionin tjetër duke shtypur dhe lëshuar pedalin e kontrollit ose butonin "RF ON/OFF"</li></ul>

### Defektet (Mesazhet e gabimeve të parikuperueshme)

NUMRI	SHKAKU	ZGJIDHJA
1	<ul style="list-style-type: none"><li>Në ekran: ROM CRC FAILURE</li><li>Kuptimi: Dështim i kontrollit të tepricës ciklike të memories vetëm për lexim në hapësirën e përdorur të adresës ROM</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Kryeni fikje dhe rindezje</li><li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li></ul>
2	<ul style="list-style-type: none"><li>Në ekran: RAM FAILURE</li><li>Kuptimi: Testi për funksionimin e vendndodhjes së memories me qasje të rastësishme dështoi</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Kryeni fikje dhe rindezje</li><li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li></ul>
3	<ul style="list-style-type: none"><li>Në ekran: AMBIENT TEMPERATURE FAIL</li><li>Kuptimi: Niveli referencë i tensionit në sistemin termocift të matjes është jashtë diapazonit të pranueshëm</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Kryeni fikje dhe rindezje</li><li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li></ul>
4	<ul style="list-style-type: none"><li>Në ekran: MEASURED POWER &lt;&lt; CALCULATED POWER</li><li>Kuptimi: Fuqia e matur është jashtë diapazonit të pranueshëm të fuqisë së llogaritur</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Kryeni fikje dhe rindezje</li><li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li></ul>
5	<ul style="list-style-type: none"><li>Në ekran: IMPEDANCE TEST FAIL</li><li>Kuptimi: Matja e rezistencës së brendshme është jashtë diapazonit të pranueshëm</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Kryeni fikje dhe rindezje</li><li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li></ul>
6	<ul style="list-style-type: none"><li>Në ekran: +48 VOLT SUPPLY FAIL</li><li>Në ekran: -12 VOLT SUPPLY FAIL</li><li>Në ekran: +12 VOLT SUPPLY FAIL</li><li>Në ekran: +5 VOLT SUPPLY FAIL</li><li>Kuptimi: Tensioni i funksionimit është jashtë diapazonit të pranueshëm</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Kryeni fikje dhe rindezje</li><li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li></ul>
7	<ul style="list-style-type: none"><li>Në ekran: RF POWER TOO HIGH WHEN ON</li><li>Kuptimi: Fuqia e shpërndarë është më e madhe se fuqia e komanduar me një vlerë specifike</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Kryeni fikje dhe rindezje</li><li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li></ul>
8	<ul style="list-style-type: none"><li>Në ekran: RF POWER TOO HIGH WHEN OFF</li><li>Kuptimi: Gjeneratori shfaq dhe nxjerr energji më të madhe se 0 W kur energjia RF është e fikur</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Kryeni fikje dhe rindezje</li><li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li></ul>

## Defektet (Mesazhet e gabimeve të parikuperueshme)

NUMRI	SHKAKU	ZGJIDHJA
9	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në ekran: FAN FAULT</li> <li>Kuptimi: Statusi i ventilatorit është i pavlefshëm</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kryeni fikje dhe rindezje</li> <li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li> </ul>
10	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në ekran: RF Eff Lim</li> <li>Kuptimi: Gabim në efëncën e transformatorit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kryeni fikje dhe rindezje</li> <li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li> </ul>
11	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në ekran: RESISTIVITY FAILED</li> <li>Kuptimi: Vlera e rezistencës së qarkut të rezistencës është jashtë diapazonit të pranueshëm</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kryeni fikje dhe rindezje</li> <li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li> </ul>
12	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në ekran: TIMER FAILURE</li> <li>Kuptimi: Funksionimi i kohëmatësit dështoi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kryeni fikje dhe rindezje</li> <li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li> </ul>
13	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në ekran: GROUND FLOAT ON A/D</li> <li>Kuptimi: Gabim i pllakës së tokëzimit në konvertuesin nga analog në dixhital</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kryeni fikje dhe rindezje</li> <li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li> </ul>
14	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në ekran: CALIBRATION VOLTAGE ON A/D</li> <li>Kuptimi: Gabim i tensionit të kalibrimit në konvertuesin nga analog në dixhital</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kryeni fikje dhe rindezje</li> <li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li> </ul>
15	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në ekran: RF ON BUTTON STUCK</li> <li>Kuptimi: Butoni "RF ON" mund të ketë ngecur</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shtypni dhe lëshoni butonin "RF ON/OFF"</li> <li>Kryeni fikje dhe rindezje</li> <li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li> </ul>
16	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në ekran: MODE BUTTON STUCK</li> <li>Kuptimi: Butoni "MODE" mund të ketë ngecur</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shtypni dhe lëshoni butonin "MODE"</li> <li>Kryeni fikje dhe rindezje</li> <li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li> </ul>
17	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në ekran: POWER/TEMPERATURE UP BUTTON STUCK</li> <li>Kuptimi: Butoni i RRRITJES SË FUQISË mund të ketë ngecur (Vini re: Butoni i rritjes së temperaturës nuk është ende i disponueshëm)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shtypni dhe lëshoni butonin E RRRITJES SË FUQISË (+)</li> <li>Kryeni fikje dhe rindezje</li> <li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li> </ul>
18	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në ekran: POWER/TEMPERATURE DOWN BUTTON STUCK</li> <li>Kuptimi: Butoni i ULJES SË FUQISË mund të ketë ngecur (Vini re: Butoni i uljes së temperaturës nuk është ende i disponueshëm)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shtypni dhe lëshoni butonin E ULJES SË FUQISË (-)</li> <li>Kryeni fikje dhe rindezje</li> <li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li> </ul>
19	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në ekran: TIME UP BUTTON STUCK</li> <li>Kuptimi: Butoni i RRRITJES SË KOHËS mund të ketë ngecur</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shtypni dhe lëshoni butonin E RRRITJES SË KOHËS (+)</li> <li>Kryeni fikje dhe rindezje</li> <li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li> </ul>
20	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në ekran: TIME DOWN BUTTON STUCK</li> <li>Kuptimi: Butoni i ULJES SË KOHËS mund të ketë ngecur</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shtypni dhe lëshoni butonin E ULJES SË KOHËS (-)</li> <li>Kryeni fikje dhe rindezje</li> <li>Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shërbimin e klientit të "AtriCure"</li> </ul>

Për më shumë informacion mbi paralajmërimet, masat e kujdesit dhe defektet, shihni udhëzimet e përdorimit të CSK-310

Për shqetësime të tjera ose për informacione të detajuara, referojuni udhëzimeve të përdorimit të gjeneratorit CSK-310 ose kontaktoni linjën direkte të shërbimit ndaj klientit të "AtriCure" në (866) 349- 2342.



Atricle Inc.  
7555 Innovation Way  
Mason, Ohio 45040 SHBA  
+1 866 349 2342  
+1 513 755 4100



Përfaqësuesi evropian:  
Atricle Europe B.V.  
De entree 260  
1101 EE Amsterdam  
NL  
+31 20 7005560  
ear@atricure.com